



Plani Strategjik i IIA Albania 2020-23

FINAL
Shtator 2020

VIZIONI I AIIA

Të jetë zëri kombëtar i profesionit të auditimit të brendshëm, duke advokuar vlerën e tij si faktor kyç në organizatë, duke promovuar praktikat më të mira dhe duke i ofruar anëtarëve tanë një shërbim të jashtëzakonshëm.

MISIONI I AIIA

Të jetë një udhëheqje dinamike në zhvillimin, promovimin dhe fuqizimin e profesionit të auditimit të brendshëm në Shqipëri.

FOKUSI I AIIA

- Praktikrat më të mira të auditimit të brendshëm;
- Zhvillim dhe rritje profesionale;
- Krijimi i grupeve profesionale;
- Promovimi i profesionit;
- Përfaqësimin profesional.

SHTYLLAT STRATEGJIKE TË AIIA

Promovimi	Proaktiv – Vizibilitet – Vazhdueshmëri
Përfaqësimi	Me impakt
Shërbimet	Cilësi – Profesionalizëm – Efektshmëri

HIGH-LEVEL STRATEGIES

Promovimi - AIIA do të promovojë shërbimet, vizionin dhe vlerat që përfaqëson në mënyrë proaktive dhe të vazhdueshme. Duke qënë në kontakt me vazhdueshëm me audiencën, AIIA do të ketë më tepër vizibilitet te anëtarët ekzistues dhe ata potencial, duke krijuar mundësi njohje me partnerë të rinj.

1. Fuqizimi i anëtarëve nëpërmjet përmirësimit të komunikimit me audiencën ekzistuese në cilësi dhe përmbajtje.
2. Promovimi i shërbimeve: anëtarësime, trajnime, certifikime, akses në standarde, praktika, udhëzime.
3. Vizibilitet nëpërmjet instrumentave të promovimit.
4. Pjesëmarrje në konferenca dhe forume në fusha të lidhura me auditimin e brendshëm.
5. Dëgjim dhe përmirësim i vazhdueshëm.

Përfaqësimi - AIIA do të ketë impakt për të sjellë ndryshime në kuadrin rregullativ në lidhje me Auditimin dhe Qeverisjen në ligjin e ndryshuar, do të arrijë marrëveshje me Njësinë e Harmonizimit të Ministrisë së Fianancave, dhe do të jetë pjesëmarrëse në projekte.

1. Marrëveshje bashkëpunimi për institucionet ndërvepruese që kanë nevojë për ekspertizë;
2. Kontribut kyc në përshtatjen e legjislacionit për Auditimin e Brendshëm në lidhje me Bashkimin Europian;
3. Përdorimi i Brandit;
4. Ekspozim tek donatorët;
5. Ekspozim në projekte.

Shërbimet - AIIA do të sjellë shërbime cilësore, profesionale dhe efektive. Nëpërmjet këtyre shërbimeve do të rritet numri i personave të trajnuar, do të shtohen anëtarët e rinj, do të rifreskohen standardet e IPPF-ve per sektorin publik, dhe do të realizohen shërbime të reja si External Quality Assessment.

FË Trajnime cilësore në 3 shtylla:

- Rifreskim standardesh dhe praktikave profesionale cdo vit
- Portofol për sektorin publik (+ NJQH)
- Portofol për sektorin privat